



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.555/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së larte ligjore Florije Krasniqi Pireva, duke vendosur përkitazi me apelin e Zarife Shala me vendbanim në Holandë, për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli i ushtruar nga Zarife Shala me vendbanim në Holandë, i paraqitur kundër KQZ-së, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, **Urdhërohet** KQZ-ja, të përfshijë apellesen në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën **30.08.2021** PZAP-i, ka pranuar një apel nga Zarife Shala me vendbanim në Holandë, në të cilën pretendohet se ka aplikuar e për regjistrim si votuese jashtë Kosove, dhe se nuk e gjen emrin në listë për të votuar si votuese jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 17 Tetor 2021.

Parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:

Apeli është i bazuar

Paneli, konstatoi se nga shkresat e lëdës dhe përgjigjja në ankesë e KQZ-së, në të cilën pohojnë se aplikuesja Zarife Shala me vendbanim në Holandë, ka dorëzuar të gjitha dokumentet, vërtetojnë se e njëjta në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotëson kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr.555-2021 më datën 31.08.2021



Kryesues i Panelit

Milena Đerić

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.